



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:270813

Datë: 25.10.2022

Numri i dokumentit: 03564556

**P.nr.2021/270813**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit F. M. nga fshati Pastasel, komuna Rahovec, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 par. 3-3.2-1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1697/2021 të datës 26.11.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Anton Hasanaj të akuzuarit dhe të dëmtuarës B. M., më datë 17.10.2022, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari,**

**F. M.**, nga i ati I., e ëma S., e lindura G., i lindur më datë ... në fshatin Pastasel, komuna Rahovec, ku edhe tani banon, me numër personal ..., i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë F A J T O R E**

### **S E P S E**

Me datë 19.11.2021, rreth orës 10:00h, në fshatin Pastasel, komuna e Rahovecit, pikërisht në shtëpinë tyre familjare, shkakton dhunë në familje, respektivisht keqtrajtim fizik, ndaj të dëmtuarës – rejtës së tij B. M., në atë mënyrë që derisa e dëmtuara i drejtohet kunatit të saj se njëri nga fëmijët e tij e kishte sulmuar vajzën e saj, ku ja tërheq vërejtjen nga këto veprime, me të dëgjuar këtë bisedë i pandehuri F. M. ngritët në këmbë duke ju drejtuar që të dëmtuarës me fjalët se kush ishte ajo që po flet kështu e ë pas e kap për fyti dhe e rrëzon në dysheme, derisa ndërhyjnë anëtarët tjerë të familjes dhe e largojnë nga aty, me ç'rast tek e dëmtuara ka shkaktuar dhimbje dhe shqetësim emocional.

**-Këso dore ka kryer veprën penale Dhune në familje nga neni 248/3-3.2-1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 6, 7, 17, 38, 39, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, si dhe neni 248/3-3.2-1 të KPK-së, të akuzuarit i shqipton:

## **DËNIMIN ME KUSHT**

Dënimin me gjobë në shume prej dyqind (200) € dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) Euro, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30) Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### **1. Ecuria e procedurës penale**

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën Përgjithshëm PP.II.nr.1697/2021 të datës 26.11.2021, kundër të akuzuarit F. M. nga fshati Pastasel, komuna Rahovec, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248/3-3.2-1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.10.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj, i akuzuari, ndërsa nuk ka qenë e dëmtuara, për të cilën gjykata nuk ka provë se është ftuar në mënyrë të rregullt.

Aktakuza me numër PP.II.nr.1697/2021 të datës 26.11.2021, u lexua dhe u arsyetua nga prokurori i shtetit Anton Hasanaj.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

### **2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë.**

I akuzuari F. M. duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka deklaruar: Se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, ndjenë keqardhje për rastin i cili i ka ndodhur, është penduar për veprime të bëra, i ka premtuar gjykatës se një veprim të tillë nuk do ta përsërit në të ardhmen, pasi qe raportet me babin i ka rregulluar, si dhe i ka propozuar gjykatës të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj, jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë i cili ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në këtë shqyrtim gjyqësor, pasi qe pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favorët dhe pasojat e mos pranimit, po ashtu duke marr për baze se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të të cilave është paraqitur gjendja faktike

e paraqitur në dispozitiv të aktakuzës, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ngarkohet e akuzuara.

E dëmtuara B. M. për ndryshe e reja e të akuzuarit ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit – vjehrrit si dhe nuk kërkon kompensimin e dëmit për dëmin e shkaktuar.

Gjykata konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 326 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari F. M., me dashje ka kryer veprën penale dhunë në familje nga neni 248/3-3.2-1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 248/3-3.2-1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale dhunë në familje: **“Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqëtrajtim fizik, psikologjik, seksual, ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes në familjen e tij dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet”.**

### 5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale dhunë në familje nga neni 248/3-3.2-1 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat materiale të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Raporti i oficerit R. B. i datës 19.11.2021;
- Deklarata e të dëmtuarës B. M. e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me datën 19.11.2021;
- Deklarata e dëshmitares N. B. e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me datën 19.11.2021;
- Deklarata e dëshmitares L. I. e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec, me datën 19.11.2021;
- Deklarata e dëshmitarit V. M. e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me datën 19.11.2021;
- Deklarata e pandehurit F. M., e dhënë në Stacionin Policor në Rahovec, me datën 19.11.2021;
- Raporti mjekësor i QMF-së në Rahovec, i datës 19.11.2021.

Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

## **6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit, gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe rregullimi raporteve, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

## **7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale**

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.6, lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.2021/270813, me datë 17.10.2022**

**Sekr. Juridike**  
**Shemsije Shehu**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Mizahir Shabani**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.